



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i
Tehnologiju-Ministry of Education Science &Technology

Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Nr. 818/01B
Datë: 11/09/2018

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në mbështetje të neneve 4, 21, 22 të Ligjit, nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 5 dhe Ligji nr. 04/L032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës si dhe duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), nxjerr:

V E N D I M

1. Të zbatohet Plani dhe Programi lëndor për klasën e parë në arsimin fillor në Republikën e Kosovës.
2. Vendimi duhet të zbatohet në të gjitha shkollat e arsimit fillor në klasët e para të Republikës së Kosovës.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi i datës: 3 gusht,2017, Ref. Nr.158/01B
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara më lartë dhe pas realizimit, identifikimit të gabimeve në programet lëndore të botuara për klasën e parë në arsimin fillor të Republikës së Kosovës, si dhe pasi që është i domosdoshëm shfuqizimi i atyre programeve me gabime dhe aprovimi i programeve të rishikuara, u vendos në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Sekretarit të përgjithshëm, MASHT;
2. Departamentit për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar, MASHT;
3. Departamentit për Politikat e Arsimit Parauniversitar, MASHT;
4. Departamentit të Inspektimit të Arsimit, MASHT;
5. Këshillit Shtetëror për Arsimin Parauniversitar, MASHT;
6. Këshillit Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve, MASHT;
7. Divizionit për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve, MASHT;
8. Divizionit për Planprogrameve dhe Teksteve Shkollore, MASHT;
9. Të gjitha Drejtorive Komunale të Arsimit;
10. Arkivit, MASHT.



Shyqiri Bytyqi,

Ministër/MASHT